



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 202, Datë 23.06.2023

MBI

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S Nr. 116, DATË 24.05.2022,
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “SPV BLUE 1” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK
“BLUE 1” ME VENDNDODHJE NË ZONËN E SHEQ MARINAS, BASHKIA FIER, ME
KAPACITET TË INSTALUAR 50 MW”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.06.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1135/10 prot., datë 22.06.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 116, datë 24.05.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Blue 1” me vendndodhje në zonën e Sheq Marinas, Bashkia Fier, me kapacitet të instaluar 50 MW”, i ndryshuar”

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 116, datë 24.05.2022, i ndryshuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 206, datë 10.08.2022, vendosi të licencojë shoqërinë “SPV BLUE 1” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Blue 1”, me kapacitet të instaluar 50 MW, për një afat 25 vjeçar duke filluar nga data e operimit por jo më vonë se data 01.07.2023.
- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1135/9 prot., datë 12.06.2023, i licencuari “SPV BLUE 1” sh.p.k., ka kërkuar ndryshimin e datës së fillimit të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, duke argumentuar se edhe pse punimet për realizimin e Parkut Fotovoltaik “Blue 1” në zonën Sheq Marinas, Fier janë drejt përfundimit, energjizimi tij mbetet në funksion të ecurisë së realizimit të projektit të ndërtimit të Nënstacionit 220/110/35/20 kV dhe Linjës së Transmetimit 220 kV Hoxharë e Re - Fier (Fier - Babicë), ndaj vendosja në operim e Parkut Fotovoltaik “Blue 1” nga Shoqëria “SPV Blue 1” sh.p.k. nuk mund të realizohet përpara datës 01.04.2024.

- Në këto rrethana, shoqëria “SPV BLUE 1” sh.p.k. ka kërkuar nga ERE ndryshimin e pikës 1 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 116, datë 24.5.2022, i ndryshuar, duke referuar si datë të fillimit të operimit të Parkut Fotovoltaik “Blue 1”, datën 1 prill 2024.
- Për sa më sipër argumentuar nga shoqëria, në rrethanat kur nuk ka filluar ende me ushtrimin e veprimtarisë së licencuar vlerësojmë të justifikuar kërkesën e saj për të filluar afatin 25-vjeçar të vlefshmërisë së licencës nga data e përditësuar tashmë e operimit, duke marrë në konsideratë se ndryshimi i datës së fillimit të afatit të vlefshmërisë së licencës nuk tejkalon as afatin e kontratës nr. 2720 Rep. dhe nr. 2066 Kol të datës 09.07.2021, të nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), në cilësinë e Autoritetit Kontraktues dhe shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k. në cilësinë e Mbajtësit të Miratimit Përfundimtar.
- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e ndryshimit të një akti, me nismën e vet organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pika 1 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 116, datë 24.05.2022, i ndryshuar, ndryshon dhe bëhet:
 1. *Të licencojë shoqërinë “SPV BLUE 1” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Blue 1”, me kapacitet të instaluar 50 MW, për një afat 25 vjeçar duke filluar nga data e operimit por jo më vonë se data 01.04. 2024.*
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “SPV BLUE 1” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe “FURNIZUESIN E TREGUT TË LIRË” sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI